




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka




Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.73/350-12188 datë 28.02.2020
REFERENC-Ë:	07Nr.350/12188 datë 24.02.2020
PËR/TO:	"Rol shpk", me pronar Jeton Zogaj Suharekë
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTOR: Sanie KUQI SHSU: Nexhmije Loshi Durmishi
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350/12188 datë 24.02.2020 nga **"Rol shpk", me pronar Jeton Zogaj Suharekë**, për Leje Ndërtimore për objektin me destinimin Depo për ruajtjen e perimeve, me etazhitet P+0, në parcelën kadastrale 02785-90, Parcela ndërtimore P-078, Tersia 9, me numër referues të çertifikatës Nr.1166-2020 të datës 28.02.2020 pronë e P.Sh. KK Suharekë shfrytëzues i përhershëm, Jeton Zogaj (qirambajtje për 99 vjet), andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 28.02.2020

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.73/350-12188

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01-Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë 05.03.2008, duke u mbështetur në Planin Rregullues Urban "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009 kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga "Rol shpk" me pronar Jeton Zogaj, Komuna Suhareke, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë:

AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:

Emri:	"Rol shpk", me pronar Jeton Zogaj	Nr. Personal	
Adresa:	Samadrexhë - Suharekë	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore: 07Nr.350/12188 datë 24.02.2020

Emri i Projektit:	DEPO PER RUAJTJEN E PERIMEVE		
Emri i Projektuesit:	"Arm-Ing" me seli në Prizren AS-Project me seli në Suharekë		
Adresa:	Komuna Parisit Nr.3/1, Prizren Brigada 123, Suharekë		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: **NDËRTIM I RI**

Adresa: Rr "Ukë Bytyqi", Shirokë			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelave kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Sipas çertifikatës me Nr.1166-2020 të datës 28.02.2020 Zona Kadastrale Suharekë	02785-90	Y=7482445.659	X=4689546.608
		Y=7482421.039	X=4689542.267
		Y=7482417.566	X=4689561.963
		Y=7482442.186	X=4689566.304

Lloji i ndërtimit të propozuar:

Depo për ruajtjen e perimëve

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Gabariti	20.00m' x 25.00m'	Katshmëria:	(P+0), sipërfaqe të përgjithshme Bruto 500m ²
Vija rregullative	Nga mesi i Rugës B-B 5.5m'	Vija ndërtimore	15m' nga vija rregullative

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore "Rol shpk", me pronar Jeton Zogaj, *Samadrexhë Suharekë*, i lejohej ndërtimi i objektit me destinim Depo për ruajtjen e perimeve me etazhitet P+0.

Lokacioni i objektit është në kuadër të Planin Rregullues Urban "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelat kadastrale 02785-90, është me destinim Depo për impute bujqësore.

Objekti ka karakter të përhershëm me katshmëri P+0. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.751/350-80773 datë 19.12.2019.

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore;
 - Informata mbi Projektuesin;
 - Informata mbi Kontraktuesin;
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevojat të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;

- Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Pose
- dyesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.


A r s y e t i m

Aplikuesi "Rol shpk", me pronar Jeton Zogaj nga Samadrexha Komuna Suharekë, përmes kërkesës 07Nr.350/12188 datë 24.02.2020 ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit Depo për ruajtjen e perimëve, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.751/350-80773 datë 19.12.2019 (kopje)
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.65/350-12188, datë: 26.02.2020, në shumë prej 1,400.00€, e paguar në Bankën per Biznes SH.A në Suharekë, sipas faturës komunale nr.0000495 datë 27.02.2020.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.37 datë:05.02.2020.
- Pëlqim sanitar – nga Inspektori i Sanitar 09Nr.36 datë:06.02.2020.
- Pëlqim për menagjimin e mbeturinave Nr.prot.27/20 datë:04.02.2020, lëshuar nga NPRM “ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Pëlqim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit –Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.12 datë: 05.02.2019.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit tek nik, KEDS-SH.A, Nr.147 datë: 20.02.2020.
- Pëlqimin për rmbrojtjen nga zjarri-nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë Nr.03/03-10 datë 14.02.2020.
- Lejen Mjedisore Komunale-nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë 03Nr.63/181-9985 datë 14.02.2020.

Faqe4nga5



- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Elaboratin gjeomekanik
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit identifikues


Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform Planin Rregullues Urban "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPH në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.73/350-12188 dt: 28.02.2020

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- Dosjes së DUP-së



Faqe5nga5

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 026, Suharekë – Kosovë
 Telefon: 029 271 318
www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizmisuhareke@rks-gov.net

REPUBLIKA E KOSOVES